

Bashkëpunimi parlamentar ne normalizimin e marrëdhënieve

Më 25-26 qershor 2016, Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar në Podgoricë të Malit të Zi tryezën e katërt të rrumbullakët me deputetët e Serbisë dhe Kosovës. Qëllimi i takimit ka qenë vlerësimi i marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, gjetja e mënyrave për kontribuimin në zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura, si dhe përpilimi i një plani të aktiviteteve të ardhshme për Grupin e Bashkëpunimit i përbërë nga deputetët e Kosovës dhe Serbisë, të formuar në takimin e tyre të fundit në Prishtinë.

Tryeza e rrumbullakët është pjesë e projektit më të gjërë të CIG të përkrahur nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës dhe të implementuar në bashkëpunim me ta.

Marrëdhëniet mes shoqërive serbe dhe shqiptare të Kosovës ende dëmtohen nga e kaluara. Sipas një deputete serbe, zemërimi dhe hakmarrja nuk po i lënë vend pjekurisë dhe kompromisit, dhe kështu po e bëjnë të pamundur që të dyja shoqëritë të bëjnë zgjedhje racionale. Ajo u ka bërë thirrje kolegëve të saj dhe qeverive të Kosovës e Serbisë t'i zgjidhin mosmarrëveshjet tani dhe mos t'ua lënë ato gjeneratave të ardhshme. “A duam që femijët tanë ta urrejnë njëri-tjetrin ashtu si ne sot?” Ajo ka thënë se politikanët mund ta zbrapsin procesin armiqësor të së kaluarës me “vetëm pak përpjekje shtesë dhe vullnet politik”. “Është zgjedhje e jona”, ka shtuar ajo, “nëse do ta bllokojmë procesin apo do ta shtyejmë ata përpara”.

Sa i përket rolit të parlamenteve, një folës u ka bërë thirrje pjesëmarrësve të vendosin një mekanizëm më strikt dhe rigoroz të monitorimit dhe mbikqyrjes mbi qeveritë e tyre, t'i thërrasin zyrtarët qeveritarë më shpesh në dëgjime parlamentare, si dhe të jenë më aktiv në marrëdhënie me publikun. Ai ka konkluduar se normalizimi nuk është thjesht një proces i dy grupeve të njerëzve nga të dyja qeveritë, por një proces mes dy shoqërive, dhe së këndejmi, parlamentarët duhet të kenë një rol më aktiv në këtë proces.

Duke i përkrahur qëndrimet e folësve të mëparshëm, një deputet nga Kosova ka thënë se politikanët në Kosovë dhe Serbi kanë hyrë në një rreth vicioz dhe për momentin janë bllokuar, kryesisht për shkak se nuk janë duke folur haptaz për realitetin e popujve të tyre.

Si shembull të regresit të tillë në marrëdhënie, ai ka përmendur integrimin e serbëve të Kosovës në shoqërinë e Kosovës dhe sistemin e saj të qeverisjes. Ai ka shtuar se serbët kanë ndërmarrë hapa prapa në këtë integrim, dhe për këtë ka fajësuar si Prishtinën ashtu edhe Beogradin. Ky folës ka thënë se Kosova dhe Serbia, si dhe serbët e shqiptarët duhet të bëjnë më shumë, e jo të presin që BE-ja të dalë me zgjidhje e kompromise për ta. Njëri nga pjesëmarrësit ka thënë se dialogu i Brukselit është duke “humbur substancën”. Një numër i pjesëmarrësve kanë thënë se

BE-ja është duke humbur ndikimin e saj mbi rajonin, dhe se anëtarësimi në BE, për dallim nga e kaluara, më nuk konsiderohet edhe me aq entuziazëm.

Komunikimi rreth dialogut është poashtu problematik. Zyrtarët qeveritarë pajtohen rreth diçkaje në Bruksel, dhe pastaj përdorin gjuhë negative dhe ofrojnë interpretime kundërtshënese apo të pasakta rreth asaj për të cilën kanë arritur marrëveshje. Një folës ka thënë se është e qartë se negociatorët shpesh duhet të pajtohen me gjëra të cilat nuk u pëlqejnë, porse ata do të duhej të përmbahen nga nevoja për t'i shprehur pakënaqësitë e tyre përmes përdorimit të gjuhës agresive.

Disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se parlamentarët do të mund të kontribuonin në ndryshimin e diskursit publik negativ në lidhje me normalizimin në përmirësimin e marrëveshjeve tashmë të arritura si dhe implementimin e tyre. Një folës ka thënë se se disa nga marrëveshjet ua kanë bërë qytetarëve jetën edhe më të vështirë, disa tjera kanë qenë shumë vështirë të justifikueshme, dhe shumë prej tyre nuk janë implementuar fare. Ky folës ka përmendur në mënyrë specifike marrëveshjen mbi lirinë e lëvizjes e cila ka krijuar shumë pengesa për vozitësit nga Kosova, duke përfshirë këtu mosnjohjen e targave RKS dhe letërnjoftimeve të Kosovoës, dhe kërkesën që ato të zëvendësohen përkohësisht me dokumente serbe. Për më shumë, një qasje e tillë bën që origjina e vozitësit të jetë lehtë e identifikueshme. Nëse vozisni nga Merdarja në drejtim të Serbisë me targa “proba” të Serbisë, atëherë është e qartë se ju jeni një vozitës nga Kosova.

Disa folës kanë qenë kundër dialogut të Brukselit për shkak se “palët janë të pabarabarta”. Për shembull, Kosova e njëj Serbinë, por Serbia nuk e njeh Kosovën. Bashkimi Evropian e njeh Serbinë, por nuk e njeh Kosovën plotësisht.

Integrimi i minoriteteve

Shumë folës kanë kundërshtuar faktin që komunitetet etnike quhen minoritete, pasi që një gjë e tillë nënkupton përjashtim, dhe në vend të kësaj kanë propozuar që të përdoret termi “komunitete”. Mungesa e integrimit të serbëve në Kosovë mbetet një pengesë e madhe në normalizimin e marrëdhënieve mes dy shoqërive. Beogradi insiston në implementimin e marrëveshjes për krijimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe, kurse qeveria e Kosovës thotë se Asociacioni/Komuniteti duhet të bazohet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Në të njëjtën kohë, partia kryesore opozitare e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje, është tërësisht kundër krijimit të Asociacionit/Komunitetit.

Një folës ka thënë se njerëzit në Kosovë janë kundër Asociacionit/Komunitetit, kurse qeveria është e obliguar që ta respektojë vullnetin e popullit. Për më shumë, ky folës ka thënë se Asociacioni/Komuniteti nuk do t'i integronte serbët, por përkundrazi, ai do të krijonte ndarje, si dhe to t'i minonte institucionet qendrore të Kosovës, sidomos në veri. Serbët besojnë fuqishëm se Asociacioni/Komuniteti do t'i mbronte interesat dhe të drejtat e tyre në Kosovë. Një pjesëmarrës serb ka thënë se Beogradi e ka të vështirë t'i besojë procesit të Brukselit dhe të shfaqë vullnet politik nëse Asociacioni/Komuniteti nuk është formuar më shumë se tri vite pas marrëveshjes së prillit 2013.

Të drejtat e minoritetit shqiptar në jug të Serbisë kanë qenë poashtu pjesë e diskutimit. Një folës ka thënë se Beogradi duhet t'i japë atyre të njëjtat të drejta të cilat i dëshiron për serbët në

Kosovë. Një tjetër folës i cili rishtaz ka vizituar hapësirat me shumicë shqiptare në Serbi ka folur për nivele shumë më të larta të papunësisë në krahasim me mesataren në pjesë tjera të Serbisë. Ai poashtu ka përmendur mungesën e mundësive ekonomike, duke shtuar se niveli i investimeve qeveritare është poashtu shumë më i ulët sesa mesatarja e investimeve në Serbi. Për më tepër, shqiptarëve atje nuk u është lejuar shfrytëzimi i teksteve shkollore nga Kosova, gjë të cilën ky folës e ka konsideruar si shkelje të të drejtave themelore të njeriut. “Ne u kemi dhënë serbëve të Kosovës shumicë të dyfishtë, kurse shqiptarët në Serbi nuk mund të marrin as libra nga Kosova”.

Shumë prej pjesëmarrësve kanë thënë se politikanët duhet të jenë të sinqertë me komunitetet e tyre, dhe t’u ndihmojnë atyre që të integrohen në shoqëritë respektive, e jo ti shfrytëzojnë ata për të avancuar qëllimet e tyre politike e personale. Ata poashtu kanë thënë se implementimi i plotë i marrëveshjeve dhe përmirësimi i marrëdhënieve mes Beogradit e Prishtinës do t’i ulte tensionet etnike në Serbi dhe Kosovë.

Personat e zhdukur

Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare, prej janarit të vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 1999, në Kosovë janë vrarë dhe zhdukur 13,146 persona. Prej tyre, 10,495 janë shqiptarë, 2,077 serbë, 574 të tjerë. Edhe sot, janë mbi 1,650 persona të zhdukur. Pjesëmarrësit kanë inkurajuar një diskurs publik si dhe iniciativa nga të gjitha palët ku merren parasysh të gjitha viktimat, pavarësisht se cilit grup etnik i takojnë. Ata kanë theksuar se në kundërshtim me një qasje të tillë, tash për tash vetëm fotografitë e shqiptarëve të zhdukur janë të vendosura para parlamentit të Kosovës, kurse para parlamentit të Serbisë janë vendur vetëm fotografitë e serbëve të zhdukur.

Ka pasur një konsensus mes pjesëmarrësve se qeveritë e Kosovës dhe Serbisë mund të bëjnë më shumë për të zbardhur fatin e personave të zhdukur duke ofruar më shumë resurse financiare, duke shkëmbyer informata rreth varrezave potenciale masive, si dhe duke rritur bashkëpunimin dhe koordinimin e delegacioneve të tyre brenda Grupit Punues për Personat e Zhdukur.

Një numër pjesëmarrësish poashtu kanë rekomanduar që çështjet të adresohen mes dy qeverive në dialogun e Brukselit. Edhe pse ka pasur konsensus të gjërë se çështja është politikisht e ndjeshme, pjesëmarrësit kanë inkurajuar qeveritë e tyre që kjo çështje të adresohet si çështje humanitare në mënyrë që bashkëpunimi të jetë sa më efikas.

Disa folës kanë thënë se përmbyllja e kësaj çështjeje jo vetëm që do t’i jepte fund njëherë e përgjithmonë vuajtjes së familjeve të personave të zhdukur, por gjithashtu do të kontribuonte në normalizimin dhe pajtimin e shoqërive serbe e shqiptare.

Paralelisht me përpjekjet për të zbardhur fatin e personave të zhdukur, sistemi gjyqësor duhet të intensifikojë përpjekjet e tij për të gjetur dhe gjykuar kryesit e veprave.

Përfundim

Pjesëmarrësit kanë ofruar një numër rekomandimesh në fushën e arsimit, sportit, kulturës, dhe aktivitete tjera shoqërore të cilat do të kontribuonin në normalizimin e marrëdhënieve mes dy shoqërive.

- **Të replikohet bashkëpunimi mes odave ekonomike të Kosovës e Serbisë.** Pjesëmarrësit kanë propozuar që në takimin e ardhshëm të ftohen përfaqësuesit e odave ekonomike me qëllim të diskutimit të bashkëpunimit të tyre, dhe mënyrës se si u qasen pengesave politike, sidomos atyre që anë të bëjnë me çështjen e statusit. Shumë folës kanë thënë se fokusimi në bashkëpunimin ekonomik dhe në tregti do të të duhej të kishte përparësi karshi çështjeve politike sepse këto janë fusha të cilat prodhojnë rezultate të menjëhershme dhe bashkojnë njerëzit.
- **Të ofrohen mundësi që serbët e Kosovës të mësojnë gjuhën shqipe.** Njohja e gjuhës shqipe jo vetëm që do t'i përmirësonte marrëdhëniet shoqërore mes serbëve e shqiptarëve, por gjithashtu do të krijonte mundësi më të mira punësimi për serbë e Kosovës, me theks të veçantë në sektorin privat. Për momentin, numri i serbëve të punësuar ne kompani private është shumë i vogël.
- **Të krijohet nje program shkëmbimi mes Universitetit të Beogradit dhe atij të Prishtinës.** Arsimi është njëra nga fushat ku bashkëpunimi është më i mundshëm, pasi që nuk është politikisht shume e ndjeshme. Edhe pse Serbia nuk e njeh Universitetin e Prishtinës, është rekomanduar që krerët e të dyja universiteteve të gjejnë mënyra që t'iu ikin pengesave politike dhe të krijojnë një program të tillë.
- **Të organizohet një ndeshje futbollit mes ish lojtarëve të klubit Partizan dhe Prishtina.** Ka ekzistuar nje konsensus se normalizimi i marrëdhënieve kërkon komunikim mes të gjitha pjesëve të shoqërisë, e jo vetëm mes dy qeverive. Së këndejmi, është rekomanduar që të organizohet një ndeshje futbollit me qëllim të promovimit të pajtimit dhe marrëdhënieve më të mira shoqërore.
- **Të organizohen takime të përbashkëta qeveritare.** Edhe pse ide mjaft vështirë e realizueshme, një folës ka propozuar mbajtjen e një takimi të përbashkët të qeverisë së Kosovës e Serbisë, të ngjajshëm me takimet e qeverisë së Kosovës me qeveritë e Maqedonisë e Shqipërisë, apo të qeverisë së Serbisë me qeveritë e Hungarisë dhe Rumanisë.
- **Të organizohen vizita të përbashkëta të deputetëve në Kosovë dhe Serbi.** Anëtarët e parlamenteve mund të organizojnë vizita të përbashkëta në hapësirat shqiptare në Serbi, dhe në hapësirat serbe ne Kosovë. Qëllimi i vizitave të tilla është që të merren informata të drejtpërdrejta në lidhje me sfidat me të cilat ballafaqohen komunitetet, si dhe të promovohet bashkëveprimi shoqëror.

Pjesëmarrësit kanë diskutuar mundësinë e lëshimit të një deklaratë të përbashkët në lidhje me personat e zhdukur. Ata kanë pasur një mirëputim të gjërë rreth përmbajtjes së deklaratës së përpiluar gjatë diskutimeve, por nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë konsensus rreth disa prej ideve dhe mënyrës se si janë paraqitur ato në deklaratë.

Pjesëmarrësit

Sipas alfabetit në gjuhën angleze

Miroslav Aleksic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Social Demokratike
Besim Beqaj, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Gordana Comic, Deputy Speaker, Parliament of Serbia, Democratic Party
Blerta Deliu Kodra, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Aida Derguti, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Arben Gashi, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Fatmir Hasani, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia për Veprim Demokratik
Teuta Haxhiu, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Donika Kadaj Bujupi, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Nada Lazic, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Lidhja e Social-Demokratëve të Vojvodinës
Vladimir Marinkovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Social Demokrate e Serbisë
Aleksandar Markovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Vladimir Orlic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Branko Ruzic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Adriatik Kelmendi, Producent i lartë, TV Kohavision
Arber Kuci, Përfaqësues në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Maja Micic, Zyrtare Nacionale e Programit, Ambasada e Zvicrës në Serbi
Milivoje Mihajlovic, Drejtor, Radio Beograd
Sanja Ivacic Perovic, Zëvendëskryeredaktore, Beta
Jean-Daniel Ruch, Ambasador i Zvicrës në Serbi dhe Mal të Zi
Saskia Salzmann, Këshilltare Rajonale e Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës
Talia Wohl, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës